



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr.2801 Prot

Përmet, më 28.09.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik **“I.D.K-KONSTRUKSION” sh.p.k & “4 A-M” sh.p.k**

Procedura e prokurimit: ***E HAPUR***

Numri i referencës së procedurës: ***REF - 67956-08-06-2020***

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i rrjetit ujitës Bodar-Kutal”.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): s’ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ***çmimi më i ulët X*** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **“I.D.K-KONSTRUKSION” sh.p.k** me NIPT K51408016J & **“4 A-M” sh.p.k** me NIPT K92005016L me vlerë të ofertës: **22 389 311,1** (njëzetë e dy milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëmbëdhjetë presje një) lekë pa TVSH dhe **26 867 173,3** (njëzetë e gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre presje tre) lekë me TVSH.
- 2- **Operatori ekonomik “MADEKONST” shpk** me NIPT L32225018N me vlerë të ofertës: **22 398 143,1** (njëzetë e dy milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dyzet e tre presje një) lekë pa TVSH dhe **26 877 771,7** (njëzetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një presje shtatë) lekë me TVSH.
- 3- **Operatori ekonomik “ROSI”shpk** me NIPT J69102223E pa vlerë të ofertës.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

- **Operatori ekonomik “MADEKONST ”shpk**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tyre në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kriteret sipas LPP e RRPP dhe kërkesave të AK në DST të kësaj procedurë prokurimi për arsye se:

Operatorit ekonomik “MADEKONST ”shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në shtojcën 12 të DST.

Operatori ekonomik “MADEKONST ”shpk në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk ka dorëzuar në SPE:

- Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5 (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument);
- Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9 (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument);
- Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10 (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument);
- Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11 (**Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument**);
- Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri (**Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument**);

Në lidhje me pikë **2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar** ky operator nuk ka dorëzuar në SPE asnjë nga dokumentat e kërkuara në pikën 2.2.1, 2.2.2 ,2.2.3 të DST.

Në lidhje me pikën **3 Për kapacitetin teknik** ky operator nuk ka dorëzuar në SPE asnjë nga dokumentat e kërkuara në pikat:

- 3.1
- 3.2
- 3.3
- 3.4
- 3.5
- 3.6
- 3.7
- 3.8
- 3.9
- 3.10

- 3.11
- 3.12
- 3.13
- 3.14
- 3.15
- 3.16
- 3.17
- 3.18
- 3.19

Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

- **Operatori ekonomik “ROSI”, shpk**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se OE “ROSI” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik “ROSI” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik, Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Oferta te kualifikuara:

- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” sh.p.k & “4 A-M” sh.p.k**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **“I.D.K-KONSTRUKSION” sh.p.k & “4 A-M” sh.p.k**, plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DST të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” sh.p.k & “4 A-M” sh.p.k me adresë Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167 Vorë, Tiranë* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **22 389 311,1** (njëzetë e dy milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëmbëdhjetë presje një) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri” kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë 18.9.2020**

Ankesa: JO

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Alma HOXHA